



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 18.4.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Andin Hoti, Salih Zyba, Danush Ademi dhe Etem Arifi.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sergjan Mitroviç.

I ftuar: Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e datës 2.4.2019;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Fillimisht, **Salih Zyba** tha se nga mbledhja e kaluar ka mbetur vazhdimi i raportimit të ministrit të MMPH-së, gjithashtu nga një mbledhje paraprake edhe ministrja e Bujqësisë, për të cilat tha se nuk e kemi arsyetimin. **Kryetari**, tha se ministrin e MMPH-së e kemi lënë të vazhdojë të raportojë në njërin nga mbledhjet e ardhshme, sepse ka disa shqetësime edhe për parqet nacionale, ku kemi pasur protesta në Pejë dhe në Junik.

Pas diskutimeve, komisioni vendosi që për temën e hidrocentraleve dhe problemeve të tjera mjedisore, me ministrin e MMPH-së, të vazhdohet në mbledhjen e radhës, ndërsa me ministren e Bujqësisë, në një mbledhje tjetër.

Në fund, kryetari konstatoi se komisioni, me 9 vota për, miratoi rendin e ditës, me plotësimin e kërkuar nga Salih Zyba, në pikën të ndryshme, për planifikimin e vizitave në terren.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 14.3.2019

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2018

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi në bazë të nenit 3 të Ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Agjencia është person juridik që për punën e vet i raporton me shkrim, një herë në vit, deri më 31 mars, Kuvendit të Republikës së Kosovës. Raporti iu është shpërndarë deputetëve, më datë 4 prill 2019, ndërsa sot për të diskutuar për raportin, i ftuar është drejtori i kësaj agjencie, Z. Bislim Zogaj, të cilin e falënderoi për pjesëmarrje dhe ia dha fjalën.

Bislim Zogaj, drejtor i AMKMK-së, në fillim e falënderoi komisionin për bashkëpunimin dhe tha se raporti është përgatitur konform formatit të caktuar nga Kuvendi dhe në raport është paraqitur planifikimi, projektimi dhe mbikëqyrja e komplekseve memoriale; menaxhimi i buxhetit të agjencisë dhe trajnimi i stafit. Ai theksoi se drejtimin e agjencisë e ka marrë në korrik të vitit 2018 dhe ka vazhduar punën aty ku ka mbetur. Në vazhdim, përmendi disa projekte të mëdha kapitale të realizuara: projekti i përfunduar në Kompleksin Memorial në Penuh në Podujevë; Kompleksi në Vrellë, ka mbetur vetëm rivarrimi; projekti i përfunduar në Marinë, i cili ka filluar para 10 viteve; projekti në përfundim e sipër, në Mejë; projekti në Koshare është duke shkuar mirë dhe është bërë konservimi i shtëpive, ku ka funksionuar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Divjakë.

Pastaj, përmendi edhe projektet që kanë vështirësi. Shqetësimet më të mëdha janë te Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, por të cilin tha se është në rrugë të mirë për t’u zgjedhur, sepse me miratimin e Ligjit për këtë kompleks, është formuar Komiteti Ndërministror dhe ata kanë filluar punën dhe besoj që shumë shpejt do të fillohet puna rreth konservimit të shtëpive të rezistencës. Ndërsa, më problematik është projekti për Memorialin “Ibrahim Rugova” në Prishtinë, ku aty ka disa probleme rreth menaxhimit, shpronësimit, prioritetëve etj., të cilat beson se do të rregullohen gjatë këtij viti. Ndërsa, si sfidë e agjencisë, mbeten shpronësimet në komplekset memoriale dhe potencoi zonën e veçantë në Malet e Berishës, Kleçkë dhe Divjakë.

Kryetari Nitaj, duke u ndërlidhur me fjalët e drejtorit Zogaj, pyeti: Cilat janë problemet në projektin e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” dhe projektin për Memorialin “Ibrahim Rugova”? Pastaj, tha se Qeveria vendosi të ndajë shumë simbolike për katedralen e djegur në Paris dhe reagimi i opinionit publik ka qenë, se si ka mundësi të ndahen mjete për të, ndërsa kullat në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” po rrënohen. Edhe pse janë shpenzuar miliona euro, problemi ekziston dhe pyeti: Kur do të fillojë të zgjidhet ky problem dhe a janë siguruar mjetet për të?

Besa Gaxherri, në fillim, u ndal te pika 4.6 e raportit, për asetet që ka në dispozicion agjencia dhe pati vërejtje se nuk pasqyron një listë komplete të asetëve me shumat e tyre. Pastaj, për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, pyeti: A do të konservohen kullat këtë vit? M; tej, shtoi se komisioni e ka vizituar kompleksin dhe ai është në gjendje shumë të rëndë dhe theksoi se duhet një auditim për 9 milionë €, të shpenzuara në këtë kompleks, sepse pa hezitim e them se janë shumë mjete e që unë kam shkuar dhe kam parë aty se janë shumë pak investime. Duhet të dimë për çdo investim, jo veç për këtë memorial, se ku kanë shkuar mjetet e buxhetit. Te projekti për Memorialin “Ibrahim Rugova”, tha se aty është pak e komplikuar dhe janë çështje të ndjeshme. Lidhur me këtë pyeti: Ku janë problemet dhe a duhet të bëhet ligj për këtë memorial apo agjencia do ta marrë përsipër zgjidhjen e problemit?

Për buxhetin për vitin 2018, tha se janë zotuar 5 milionë e 102 mijë €, ndërsa shpenzimet totale janë 88.61% dhe pastaj u ndal te raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe citoi një rekomandim: “*ka keqklasifikim të shpenzimeve dhe planifikimet jo të mira të projekteve rezultojnë me nevojën për ndryshime në projekte, e që kjo reflekton në krijimin*

e kostove shtesë. Si rezultat i kësaj, këto punë shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera, duke pamundësuar financimin e projekteve tjera”, të cilat tha se janë vërejtur edhe te ndarja e buxhetit. Ajo potencoi se ka edhe shpërputhje në mes planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2018, duke përmendur disa shembuj: Shpenzimet për shërbime të zotuar 23.500 €, ndërsa të shpenzuara 26,834 €; shpenzimet kontraktuese tjera nuk e dimë çka janë, të planifikuara 9,000 €, ndërsa janë shpenzuar 16,067 €; blerja e mobileve, të planifikuara 9.500 €, të shpenzuara 11,632 €.

Saranda Bogujevci, deputete e Kuvendit, pasi falënderoi për mundësinë për të marrë fjalën, theksoi se çdo ditë është duke u zhdukur trashëgimia që e kemi, pastaj shtroi disa pyetje: Sa është duke u marrë agjencia me ruajtjen e kësaj trashëgimie? Sa është e kyçur Ministria e Kulturës te Kompleksi Memorial “Adem Jashari”? Pra, ajo ka departamentin që merret me çështjen e trashëgimisë e në fakt këto memoriale hyjnë si pjesë e trashëgimisë dhe propozoi që agjencia të mbikëqyret nga Komisioni për Kulturë, pasi që kjo është fushë e trashëgimisë. Për Kompleksin Memorial “Demë Ahmeti”, tha se është ngritur si çështje prej vitit 2017 dhe projekti për këtë është përgatitur nga ekspertët e Ministrisë së Kulturës, ka pasur të gjitha specifikat dhe mënyrën e konservimit. Lidhur me këtë, pyeti: çka ka ndodhur aty, pse është rrënuar shtëpia ekzistuese origjinale? Në fund sugjeroi që të kihet kujdes te projekti “Adem Jashari”, të ruhet pjesa origjinale ekzistuese.

Ganimete Musliu, për raportin, tha se është më i detajuar se në vitin e kaluar, ndërsa problemet janë të njëjta. Në kuadër të kësaj, paraqiti shqetësimin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe tha se nga vet fakti që nuk dihet një datë se kur fillon projekti i konservimit, mund të thuhet se nuk po bëhet asgjë. Ndërsa, për Memorialin “Ibrahim Rugova”, propozoi organizimin e një tryeze të përbashkët për identifikimin e problemeve, duke përfshirë të gjithë aktorët, si: Komuna e Prishtinës, komisioni, agjencia, etj.

Në vazhdim, ajo u ndal te mbajtja e përvjetorëve të masakrave, të cilat janë shumë dhe pyeti: A ka menduar agjencia që në të ardhmen ta kemi një memorial të përbashkët, ku do të jenë të shkruar të gjithë emrat e atyre njerëzve që janë masakruar në mënyrën më të tmerrshme dhe të bëhet një ditë e veçantë, ku do të kujtohen të masakruarit, të gjithë të rënë, martirët e martirizuar për lirinë e Kosovës? Pastaj shtoi se të gjithë memorialët duhet ta kenë vëmendjen e duhur dhe të njëjtë të institucioneve. Në këtë rast, përmendi përvjetorin e maskuarës së rëndë në Celinë, me mbi 100 njerëz, përvjetorin e masakrës së Poklekut dhe Çikatovës, ku familjarët duhet t’i ruajnë fotografitë që paraqesin gjenocidin dhe krimin dhe ato janë pasuri kombëtare. Pyeti: A ka menduar agjencia për një muze për shtëpinë e Poklekut?

Duke përmendur një shembull të mirë të mirëmbajtjes, për Kompleksin Memorial në Kleçkë, pyeti: Cilat komplekse mbikëqyren dhe a kanë të punësuar që të kujdesen për to dhe cilat kanë nevojë për mbikëqyrje?

Salih Zyba, në fillim, duke u ndërlidhur me fjalën e drejtorit Zogaj, shtroi disa pyetje: Çka ka në plan të punës Komiteti Ndërministror për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”? Cilat janë arsytet e konstatimit të drejtorit se është mirë që nuk është realizuar projekti i MMPH-së, për Memorialin “Ibrahim Rugova”, duke e ditur se gjendja aty është e mjerueshme dhe me rreziqe për banorët? Cili është roli i agjencisë në mosrealizimin e disa projekteve, pasi u tha se ka ngecje në procedura?

Pastaj paraqiti disa vërejtje për raportin: më se 50% e raportit përfshin aftësimin e stafit në IKAP, më shumë se sa projektet milionëshe të memorialeve dhe organogrami i agjencisë duket gjysmak. Po ashtu, thuhet se agjencia nuk ka bord. Cili ka qenë qëllimi, pse? Në faqe 5, te korniza ligjore, thuhet se nuk ka pasur vështirësi në zbatim të ligjit, ndërsa në faqen 29 kërkohet ndryshim i ligjit. Nuk janë të përfshirë: investimet individuale, familjare, grupore, shtetërore, si kategori të ndryshme në këtë raport. Nuk ka një link në ueb faqen e agjencisë për të gjitha masakrat për informim të qytetarëve. Në fund, tha se raporti duhet të plotësohet.

Salih Salihu, duke folur për buxhetin e agjencisë, pyeti: Cilat janë planet dhe prioritetet e agjencisë për vitin 2019 dhe cilat janë kriteret e caktimit të këtyre prioritetëve, a janë kriter shkalla e

shkatërrimit apo rëndësia? Ndërsa, përveç projekteve të Kompleksit Memorial “Adem Jashari” dhe Memorialit “Ibrahim Rugova”, që me siguri do të shkojë pjesa më e madhe e buxhetit, pyeti: Cilat janë memorialet, varrezat apo shtëpitë muze, në të cilat do të intervenohet gjatë këtij viti?

Lutfi Zharku, ngriti dy çështje lidhur planin e punës për vitin 2019. Së pari në lidhje me bartjen e projekteve nga MMPH dhe pyeti: A është fjala për projektet që aktualisht i ka ministria dhe i ka në buxhet e që duhet pritur deri në revidimin e buxhetit, a janë projekte në vijim e sipër, dhe nëse ka filluar në ministri, është problem të barten apo është menduar për projektet që janë kryer e si aset të barten në agjenci? Ndërsa, lidhur me mungesën e mjeteve buxhetore për strategji dhe plan veprimi, pyeti: Çka nevojiten mjetet buxhetore për ta realizuar këtë aktivitet? Më tej, shtoi se në kohën kur ka qenë ministër, shumica e strategjive janë kryer nga vetë punëtorët e ministrive.

Bislim Zogaj, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara si vijon:

Prioritet është projekti i Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, por pasi që Kuvendi ka miratuar ligjin dhe sipas ligjit është formuar edhe Komiteti Ndërministror, të cilin e udhëheq zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, kompetencat kanë kaluar aty, por edhe unë jam pjesë e atij pastaj edhe familja Jashari, kryetari i Skenderajt etj. Prandaj, tha se nuk e marr tash përgjegjësinë të jap premtim se kur do të fillojë, sepse kjo varet nga Komiteti Ndërministror. Nuk janë në pyetje paratë për projektin, por të bëhet një projekt sa më i mirë dhe më i dinjitetshëm dhe besoj që është në rrugë të mirë e shumë shpejt do të fillojë puna rreth konservimit të shtëpive të rezistencës. Këtë vit janë ndarë rreth 3 milionë euro, vetëm për konservim dhe janë të mjaftueshme. Për keqpërdorimet e përmendura të 9 milionë eurove, tha se nuk ia lejoj vetes të merrem me të kaluarën dhe kushdo që ka interesim për të hetuar, e ka derën hapur, ndërsa në lidhje me këtë, ai shtoi se çdo vit ka pasur auditime nga Ministria e Financave dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Agjencia është e hapur për bashkëpunim me çdo kënd, jo vetëm me Ministrinë e Kulturës, por edhe me qytetarët. Në rastin konkret, sa i përket Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, nuk kemi ndonjë marrëveshje me Ministrinë e Kulturës, sepse ashtu e përcakton ligji. Prioritet i agjencisë është ruajtja e objekteve, ashtu siç janë origjinale.

Për projektin e Memorialit “Ibrahim Rugova” në Prishtinë, ka disa probleme. Aty, fillimisht, ka qenë memorial i paraluftës, pastaj aty janë varrosur Ibrahim Rugova, Adem Demaçi, Ahmet Krasniqi, Ilir Konushevci, dëshmorët e veteranët dhe varrimi është bërë pa një kriter. Një projekt që ka qenë nga MMPH-ja nuk është realizuar dhe është mirë që nuk është realizuar, sepse nuk do të ishte i dinjitetshëm dhe se në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, duhet një riorganizim i këtij memoriali me një projekt të ri, duke siguruar një pronë tjetër nga komuna për t’i rivarrosur veteranët.

Për shtëpinë e “Demë Ahmeti”, ka filluar procedura më herët dhe agjencia kur ka filluar projektin me pronarët e shtëpive, ata kane shprehur gatishmërinë që pa shpronësim të fillojë konservimi dhe se objektivi ka qenë të ruhen shtëpitë siç kanë qenë, por sa kam njohuri, punëkryerësi gjatë punëve e ka dëmtuar. Gjithashtu, është një lëndë në procedurë dhe organet kompetente do të japin vlerësimin. Vitin e kaluar i kemi ridestinuuar mjetet nga ky projekt, për shkak të pengesave që kanë bërë familjarët për punë dhe shpresoj se nga Qeveria shumë shpejt do të merret vendim për shpronësimin e atyre pronave dhe pastaj të vazhdohet konservimi.

Do të bëhet evidentimi i të gjitha masakrave në tërë Kosovën dhe së paku nga një pllakë me emra, do të sigurohet për secilin memorial. Për projektin për konservimin e shtëpisë në Poklek, tha se është hapur tenderi, dhe vitin tjetër, do të bëhet edhe konservimi. Vetëm disa memoriale të mëdha kanë punëtorë, ndërsa mirëmbajtja bëhet nga kompanitë përmes tenderëve. Në Mejë ka pasur një hetim për keqpërdorim dhe sipas informacioneve ka përfunduar hetimi, pa të gjetura, sepse aty nuk ka pasur keqpërdorim, por vonesë në realizmin e projektit.

Të gjitha projektet do t’i paraqesim në ueb faqe dhe jemi në rikonstruktimin e një ueb-faqeje të re të agjencisë, por kërkoi mirëkuptimin e komisionit, sepse identifikimi i të gjithave merr kohë dhe kjo varet edhe nga bashkëpunimi i komunave, pasi që agjencia ka vetëm 12 punëtorë. Ndërsa, për vlerat konkrete të projekteve do të marrë shumë kohë, sepse shumë prej tyre janë realizuar në

mënyre vullnetare dhe nuk e dimë shumën e mjeteve, ndërsa dihet vetëm për projektet e mëdha. Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, ka filluar puna rreth strategjisë. Ndërsa, për projektet që duhet të barten nga MMPH-ja, përmendi projektin për “Afrim Zhitinë”, ku pritet të rregullohet shpronësimi.

Kryetari, pas diskutimeve, konstatoi se rekomandimi për raportin do të votohet, pasi që të plotësohet, në bazë të vërejtjeve dhe rekomandimeve të dhëna nga deputetët, me një evidencë të plotë të të gjitha asetëve dhe të eliminohen pjesët e panevojshme.

4. Të ndryshme

Salih Zyba, tha se në mbledhjen e fundit të komisionit është kërkuar një propozim për vizita në terren për monitorimin e gjendjes së mjedisit nga ndikimi i gurëthyesve, hidrocentraleve dhe deponitë e mbeturinave dhe kërkoi që të bëhet një agjendë e këtyre vizitave. **Kryetari** propozoi që një draft-agjendë të këtyre vizitave të përgatitet nga Salih Zyba dhe të diskutohet në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj